



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

**PROGRAMI AVANCOJMË KOSOVËN SË BASHKU –ALTERNATIVA LOKALE
THIRRJE PËR APLIKIM RFA-03-AKT-LS**

Data e lëshimit: 11 mars, 2015

Afati i fundit për dorëzim: 13 prill, 2015 në ora 3:30pm

Të nderuar aplikues,

Community Development Fund, partner implementues i programit të USAID-it "Avancojmë Kosovën së Bashku - Alternativa Lokale (AKT-LS)" në Kosovë, në përputhje me autorizimin nga Akti për Ndhimë të Jashtme (Foreign Assistance Act) të vitit 1961, të ndryshuar, dhe në përputhje me Cooperative Agreement të USAID-it Nr. AID-167-A-14-00.008, është në proces të kërkimit të aplikacioneve nga organizatat e kualifikuara joqeveritare kosovare për të implementuar programin e granteve "Avancojmë Kosovën së Bashku" –Alternativa Lokale" në mbështetje të USAID/ Demokracia dhe Qeverisja në Kosovë " (përshkrimi i detajuar i projektit gjendet në Seksionin I, Përshkrim i mundësisë së financimit). Asistenca do të jetë në formë të marrëveshjeve për grant të Thjeshtuar, Detyrime Fikse ose në-mallra në përputhje me Kapitullin 303 të Automated Directives System të USAID-it (ADS303).

Qëllimi i kësaj ftese për aplikim është kontributi drejtë arritjes së objektivave të programit Avancojmë Kosovën së Bashku veçanërisht nr. 1 dhe 3:

1. Përmirësimi i komunikimit autonom horizontal në mes të: (a) komunitetit shqiptar dhe komuniteteve jo-shumicë të Kosovës; dhe (b) QeK dhe komunitetet jo-shumicë;
2. Përmirësimi i mundësive ekonomike në komunat e synuara;
3. Rritja e efikasitetit dhe kapacitetit të administratave komunale të synuara për t'iu përgjigjur nevojave të të gjithë qytetarëve të tyre.

Në bazë të 22 CFR 226.81, fitimi nga ky grant nuk është i lejuar. Megjithatë, të gjitha shpenzimet e arsyeshme, alokueshme dhe të lejueshme, që janë të lidhura me programin e grantit dhe që janë në përputhje me standardet e aplikueshme të kostos (22CFR226, OMB Qarkorja A-122, A-21, dhe FAR Pjesa 31) mund të paguhet nga granti.

Të gjitha grantet për organizatat jo amerikane do të administrohen në përputhje me rregulloret në fuqi si më poshtë:

- ADS303, Dispozitat Standarde të detyrueshme për Grante
- 22 CFR 226
- Qarkorja OBM, në fuqi
- Dispozitat Standarde për jo amerikan dhe OJQ-të jo amerikane
- 48 CFR 31.2 (për organizatat fitimprurëse)

Rregulloret të listuara më sipër mund t'i qaseni nëpërmjet faqes së internetit të USAID-it:
<http://www.usaid.gov/business/regulations/>

Në varësi të disponueshmërisë së fondeve, ne parashikojmë dhënien e 20 granteve përgjatë programit ose deri në fund të muajit maj të vitit 2015. Madhësia e çdo granti të vetëm të

dhënë sipas kësaj ftese për aplikacione nuk do të tejkalojnë shumën \$5,000 për GRUPIN 1, \$ 25,000 për GRUPIN 2, \$ 50,000 për GRUPIN 3 dhe \$100,000 për GRUPIN 4.

Avancojmë Kosovën së Bashku - Alternativa Lokale/USAID rezervon të drejtën për të financuar ndonjë ose asnjë prej aplikacioneve të dorëzuara. Programi "Avancojmë Kosovën së bashku - Alternativa Lokale" kërkon nga aplikuesit të demonstrojnë përkushtimin e tyre për suksesin e programit, duke përfshirë ndarjen e kostos.

Kjo RFA(kërkesë për aplikim) është duke u lëshuar për qëllimet e këtij programi dhe përbëhet nga shkresa përcjellëse dhe nga savijon:

- Seksioni I – Përshkrimi i mundësisë për financim;
- Seksioni II – Informata për dhënien e grantit;
- Seksioni III – Informata për kualifikueshmëri;
- Seksioni IV – Informata për dorëzimin e aplikacioneve dhe kontaktet;
- Seksioni V – Informata mbi shqyrtimin e aplikacionit
- Seksioni VI – Informata për administrimin e dhënies së granteve;
- Seksioni VII – Informata të tjera; dhe
- Seksioni VIII – Shtojcat.

Faleminderit për interesimin tuaj.

Me respekt,
Artan Avdiu,
Menaxher i Projektit

cc: Agron Selmani, Menaxher i Granteve
Nenad Maksimovic, Udhëheqës i Komponentës për Angazhim Qytetar

Seksioni I: Përshkrimi i mundësisë për financim

IA. Historiku – Hyrje

Programi AKT (gjithashtu AKT–LS) zbatohet në 16 komuna¹me prezencë të konsiderueshme të komunitetit serb. Në thelb, të tri ndërhyrjet janë të dizajnuara për të kontribuar në përfshirjen e përsheptuar të komunitetit serb në jetën institucionale dhe politike në Kosovë dhe rritjen e shkëmbimeve mes shumicës dhe pakicës në të gjitha sferat e jetës. Përmirësimi i sistemit të ofrimit të infrastrukturës dhe shërbimeve në shkallë të vogël, së bashku me aftësinë në rritje për ofrimin e shërbimeve cilësore nga ana e qeverive lokale dhe avokimin efikas të nevojave dhe prioriteteve të komunitetit, janë të përfshira në projekt si dimensione të ndryshme të intervenimit. Këto dimensione pritet të çojnë në përmirësimin e lidhjeve horizontale me të gjithë komunat dhe lidhjeve vertikale me ministritë e linjës, përmes të cilave do të përmirësohen jetët e komuniteteve.

Punësimi dhe zhvillimi ekonomik janë parashikuar poashtu nga projekti si masat kryesore të ndërhyrjes që kanë për qëllim të kontribuojnë në përfshirjen e përgjithshme të ekonomive në 16 komunat përfituese. Ofrimi i mundësive për individët me predispozita sipërmarrëse dhe masave të zhvillimit të fuqisë punëtore, janë dy mjetet kryesore që do të përdoren për nxitjen e punësimit dhe vetëpunësimit në komunitetet e synuara.

Për më tepër, programi do të ofrojë ndihmë për komunat vendore me qëllim të ofrimit të shërbimeve në mënyrën më efikase, duke përdorur procese transparente, që rezultojnë në vendosjen e shumë standardeve në të gjitha komunat, të tilla si: krijimi i planeve vjetore të punës, planet e veprimit për përmirësimin e shërbimeve (PVPSH) dhe planet e angazhimit të qytetarëve. Kjo ndihmë është veçanërisht e dobishme për komunat e sapo krijuara, të cilat zakonisht nuk kanë udhëheqësi me përvojë. Kjo asistencë do të ndihmojë komunat e synuara që të vazhdojnë me fillimin e nismave praktike dhe konkrete që do të forcojnë legjitimitetin e sistemit të pushtetit lokal në Kosovë dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve në komunat e synuara

IB. Përshkrimi i projektit

Avancojmë Kosovën së Bashku - Alternativa lokale (AKT - LS) është një projekt tre-vjeçar që synon rritjen e bashkëpunimit dhe ndërveprimit konstruktiv ndëretnik, kryesisht ndërmjet komunitetit shumicë shqiptar të Kosovës dhe komunitetit serb të Kosovës, e cila është jetike për sigurinë dhe stabilitetin e Ballkanit. AKT - LS është pjesë e USAID Forward, strategji e re e USAID-it për ofrimin e ndihmës zhvillimore, ku përfshirja e njohurive dhe ekspertizës lokale është thelbësore për maksimizimin e efikasitetit të ndihmës. Projekti AKT-LS është pjesë e Programit AKT, e cila përveç ndërhyrjes që është subjekt i këtij dokumenti, gjithashtu përfshin Projektin AKT US, që implementohet nga Chemonics Inc. Dy projekte të zbatuara nga konzorciumi i udhëhequr nga AKT US dhe CDF të cilat kontribuojnë në objektivat e njëjta të zhvillimit dhe pritet të bashkëpunojnë ngushtë në zbatimin e masave të tyre dhe arritjen e sinergjive.

AKT - LS si komponentë e Programit AKT, ka një buxhet prej **\$ 7 milion**. Nga këto, një investim neto prej **\$ 5 milion** është parashikuar të zbatohet si ndërhyrje e drejtpërdrejtë me grante përmes tri skemave të ndryshme të granteve, një për komunat, një për zhvillimin e sektorit privat, dhe një për mbështetjen e përpjekjeve të shoqërisë civile dhe iniciativave të tjera ndëretnike.

¹Komunat përfshijnë: Gjilan/Gnjilane, Graçanicë/Gračanica, Istog/Istok, Klinë/Klina, Kllokot/Klokot, Leposaviq/Leposavić, Mitrovicë e Veriut/ North Mitrovica, Novobërdë/NovoBrdo, Obiliq/Obilić, Partesh/Parteš, Pejë/Peć, Ranilluk/Ranilug, Shtërpçë/Štrpce, Vushtrri/Vučitrn, Zubin Potok/Zubin Potok dhe Zveçan/Zvečan.

IC. Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes

AKT LS përmes Komponentës për Angazhim Qytetar ka për qëllim nxitjen e bashkëpunimit pozitiv dhe konstruktiv ndëretnik midis popullsisë jo-shumicë serbe dhe komunitetit shumicë shqiptarë në të gjitha 16 komunitetet e synuara përmes ofrimit të mbështetjes për aktivitetet e përshtatura për të nxitur bashkëpunimin në mes të komuniteteve të ndryshme etnike. AKT LS fton OJQ-të e regjistruara vendore që të paraqesin kërkesën/aplikimin për organizimin e ngjarjeve kulturore në shkallë të vogël në vlerën deri në 5.000 dollarë amerikanë për GRUPIN 1, mobilizimin e grupeve të marginalizuara, projektet e avokimit dhe të fuqizimit, në vlerë deri në \$ 25,000 për GRUPIN 2, ngritja e kapaciteteve dhe asistencë teknike për qeveritë lokale, OShC-të apo komunitetet në vlerë deri në 50,000 dollarë për GRUPIN 3 dhe iniciativat më të mëdha që synojnë të gjitha apo shumicën e 16 komunave të përfshira në projekt në vlerë deri në 100,000 \$ për GRUPIN 4

TE GJITHA GRUPET

Kriteret e mëposhtme janë të zbatueshme për aplikantët në të gjitha GRUPET:

- Aplikantët duhet të jenë të regjistruar si OJQ në Kosovë;
- Aplikantët veprojnë vet apo si pjesë të konzorciumit dhe janë vërtetë të interesuar në promovimin e bashkëpunimit dhe të komunikimit ndëretnik;
- Të mos bëjë ndonjë veprimtari që është e paligjshme sipas ligjeve dhe rendit kushtetues të Kosovës;
- Përvojë të dokumentuar në menaxhimin e buxheteve dhe projektet me të cilat kërkohen përmes aplikimit të grantit të ngjashme;
- Të jetë inovativ dhe unik;
- Të vijë dhe të zhvillohet në mënyrë të pavarur nga aplikanti;
- Të jetë në përputhje me dhe të mbështesë strategjinë dhe objektivat e USAID/AKT – LS;
- Të jetë në gjendje për të përmirësuar marrëdhëniet ndëretnike në zonat e synuara të Programit AKT – LS;

GRUPI 1:

Disa aktivitete indikative janë dhënë më poshtë, por nuk janë kufizuar vetëm në:

- Foto ose video kampe për të rinjtë shumë-etnik përcjellur nga udhëtimet në ekspozita publike;
- Panairët tradicionale që përfshijnë grupe të ndryshme etnike në Kosovë;
- Udhëtime shkollore ndëretnike në ngjarjet dhe vendet kulturore;
- Festivale muzikore multi-etnike / muzikë bashkëkohore / festivale tradicionale të muzikës.

GRUPI 2:

Disa aktivitete indikative janë dhënë më poshtë, por nuk janë kufizuar vetëm në:

- Iniciativa avokuese që synojnë përmirësimin e aftësive të kategorive të rrezikuara për të përfaqësuar më mirë interesat e tyre në proceset e hartimit të politikave;
- Kryerja e një sërë trajnimesh administrative të shkrim-leximit për praktikantë të grupeve të rrezikuara në institucionet publike;
- Aktivitete ndërgjegjësuese që synojnë rritjen e përfshirjes së grupeve rrezikuara në shoqërinë e Kosovës;

- Rritja e pjesëmarrjes së grupeve të rrezikuara në të gjitha sektorët e shoqërisë;
- Përmirësimi i pavarësisë dhe hapësirë për veprimtarinë e anëtarëve të grupeve të rrezikuara.

GRUPI 3:

Të gjitha aplikacionet e dorëzuara për GRUPIN 3, duhet të paraqiten prej së paku dy organizatave që vijnë njëra nga popullsia shumicë dhe tjetra nga komunitetet jo-shumicë. Aplikimet nën këtë GRUP duhet të dizajnohen si të tillë që ata të kontribuojnë në zhvillimin e shoqërisë civile, komuniteteve, fuqizimin e grupeve të rrezikuara dhe të marginalizuara. Prioritet do t'i jepet strukturave formale rinore (si Këshillave të Veprimit Rinor Lokal) dhe grupeve të grave. Disa aktivitete indikative janë dhënë më poshtë, por nuk janë kufizuar vetëm në:

- Asistencë teknike për OSHC-të dhe grupet e komunitetit me qëllim përmirësimin e përfaqësimit të Pushtetit Lokal dhe llogaridhënie ndaj zgjedhësve të tyre;
- Zhvillimi organizativ dhe mbështetje për organizatat anëtare dhe grupet e komunitetit me interes specifik në procesin e hartimit të politikave;
- Ndërtimi i kanaleve të komunikimit dhe bashkëpunimit midis sektorëve;
- Krijimi i lidhjeve midis komuniteteve, grupeve, organizatave shumicë dhe jo-shumicë;
- Përmirësimin e aftësisë së qeverive lokale për të adresuar siç duhet sfidat dhe prioritetet e elektoratit që ata përfaqësojnë, nëpërmjet ngritjes së kanaleve të reagimit qytetar dhe objekteve të tjera të komunikimit që i shërbejnë përfaqësimit të interesave të komuniteteve lokale;
- Rritja e transparencës dhe llogaridhënies së qeverive vendore për t'iu përgjigjur nevojave të qytetarëve;
- Asistencë teknike për sektorin privat, që synon përmirësimin e ndërmarrësve të bizneseve mikro, të vogla dhe të mesme, përmes trajnimit dhe mentorimit në biznes;
- Asistencë teknike për sektorin privat dhe bizneset/shoqatat e sektorit, që synon përmirësimin e depërtimit NMVM-ve në tregun e Kosovës dhe lidhjet e tregut, përmes panairëve dhe B2B-ve.

GRUPI 4:

Të gjitha aplikacionet e dorëzuara për GRUPIN 4, duhet të paraqiten prej së paku dy organizatave që vijnë njëra nga popullsia shumicë dhe tjetra nga komunitetet jo-shumicë. Gjatësia e aktiviteteve të parapara nën GRUPIN 4, mund të shtrihet deri në 18 muaj. Grantet e GRUPIT 4 kanë për qëllim përmirësimin e lidhjeve në mes të institucioneve lokale dhe zgjedhësve, për të përmirësuar funksionimin e tyre dhe për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin e tyre. Ajo kërkon angazhimin aktiv të OSHC-ve në ofrimin e ndihmës për qeveritë lokale për të përballuar më mirë presionet dhe sfidat. Disa aktivitete indikative janë dhënë më poshtë, por nuk janë kufizuar vetëm në:

- Ndërtimi i kapaciteteve në bërjen e politikave, analiza dhe monitorim të institucioneve lokale dhe organizatave;
- Ngritja e partneriteteve ndër-komunale për të adresuar sfidat që kalojnë kufijtë e komunave;
- Të zbatohen në të paktën katër komuna;
- Përmirësimi i cilësisë dhe sasisë së shërbimeve të ofruara nga komunat;
- Adresimi i prioritetëve të komunitetit dhe çështjeve më të gjera të shqetësimit për pjesën më të madhe të popullsisë;

- Të prezantojë potenciali për përsëritje dhe sinergji dhe të ndërtojë histori suksesi të bashkëpunimit ndër-etnik.

Seksioni II: Informata mbi dhënien e grantit

1. Projekti Avancojmë Kosovën së Bashku - Alternativa Lokale synon të financojë një grant të vetëm në përgjigje të kësaj RFA. Kostot e lejueshme duhet të jetë në përputhje me politikat dhe procedurat e USAID-it dhe të jenë të arsyeshme, të lejueshme, të alokueshme dhe të dokumentuara mirë si dhe të arsyetuara për projektin dhe buxhetin e propozuar.

2. Sipas kësaj RFA granti do të jepet për llojet e mëposhtme të organizatave:

- Organizatat e Shoqërisë Civile (OShC) të regjistruara në Kosovë²

3. Grantet pritet të jenë me kohëzgjatje më pak se një vit me përjashtim të GRUPIT 4, ku aktivitetet mund të zgjasin deri në 18 muaj.

4. Të gjitha aplikacionet për grante të pranuar në afat do të shqyrtohen nga Komisioni për shqyrtim dhe vlerësim (REC) i programit Avancojmë Kosovën së Bashku - Alternativa Lokale brenda tre javësh pas afatit të fundit për dorëzim, në përputhje me kriteret për vlerësim të përshkruara në këtë RFA.

5. Aplikacionet e pranuar pas afatit nuk do të merren parasysh në procesin e shqyrtimit. Edhe kopjet elektronike edhe fizike duhet të dorëzohen para afatit të fundit.

6. Pas dorëzimit të aplikacionit tuaj të *plotë*, brenda tridhjetë ditëve kalendarike nga afati i fundit për pranimin e aplikacioneve, Menaxheri i Grantëve i programit Avancojmë Kosovën së bashku - Alternativa Lokale do të ju dërgojë një njoftim me e-mail me ç' rast do të ju njoftoj lidhur me orarin e shqyrtimit të aplikacionit tuaj nga REC. Aplikuesit që marrin pikët më të larta, deri në maksimumin e buxhetit në dispozicion, do të kalojnë në fazën e negociatave të procesit të para-dhënies së grantit. Shënim: Përfshirja e një buxheti të detajuar dhe shënimet e hollësishme të buxhetit do të ndihmojnë për të përshpejtuar fazën e negociatave. Pasi një kërkesë të jetë negociuar me sukses dhe të jetë miratuar nga USAID, ajo do të financohet kur të jenë të disponueshme burimet.

7. Do të jepen marrëveshjet për grante të Thjeshtësuara, Detyrime Fikse apo në-mallra.

8. Vërtetimet para dhënies së grantit, sigurimet dhe pasqyrat tjera të pranuesit - Të gjitha organizatat jo-amerikane para nënshkrimit të ndonjë marrëveshjeje për grant duhet të nënshkruajnë vërtetimet vijuese, deklaratat e sigurisë dhe të tjera: një kopje të nënshkruar të Vërtetimit se nuk janë të lidhura me financimin e terrorizmit, e kërkuar nga Internal Mandatory Reference AAPD 04-14, vetë-vërtetimit dhe vërtetimit të pranuesit.

Seksioni III: Informata mbi kualifikueshmërinë për grant

Kjo RFA është e hapur për organizatat e regjistruara në Kosovë (për llojet më të veçanta të organizatave referojuni Seksionit II më sipër), përfshirë këtu organizatat fetare (në përputhje me Executive Order 13279).

Për më tepër, Përfituesit duhet:

- Të jenë të regjistruar dhe pranuar ligjërisht sipas ligjeve të Kosovës [**ju lutemi sigurone kopjen e regjistrimit**];
- të kenë personel dhe kapacitet të mjaftueshëm për të ndërmarrë aktivitetet e propozuara;

²Për qëllimet e kësaj Kërkesë për Aplikacione, termi OShC përfshin organizatat jo-qeveritare (OJQ), institucionet arsimore, bizneset private, shoqatat profesionale, dhe organizata të tjera të bazuara në komunitet.

- të posedojnë kapacitetet të shëndosha menaxheriale, teknike, dhe institucionale për të arritur rezultatet e projektit;
- të posedojnë një sistem të kontrolleve të brendshme që ruajnë pasuritë dhe mbrojnë kundër mashtrimit, mbeturinave, dhe konfliktit të interesit;
- të jenë të gatshëm për të nënshkruar vërtetimet e aplikueshme; dhe
- të mos jenë pjesë e listës së Sistemit për Menaxhimin e Grantit (SAM) dhe/ose SDN të OFAC-ut në dhe listën e personave të bllokuar.

Organizatrat e mëposhtme nuk kualifikohen për grante nga projekti Avancojmë Kosovën së Bashku - Alternativa Lokale:

- Partitë politike, degët e tyre, ose bashkëpunëtorët;
- Organizatat që gjenden në SAM, OFAC apolistën U.N. 1267;
- Organizatat që promovojnë apo angazhohen në veprimtari të paligjshme ose aktivitete anti-demokratike;
- Organizatat fetare synimet e të cilave janë diskriminuese dhe/ose për qëllime religjioze, dhe objektivi kryesor i grantit është i një natyre religjioze;
- Çdo subjekt i lidhur me Community Development Fund (CDF) (Avancojmë Kosovën së Bashku - Alternativa Lokale), zyrtarët e saj, drejtorët, apo punonjësit; dhe
- Organizatat publike ndërkombëtare.

Seksioni IV: Informata për dorëzimin e aplikacioneve dhe kontaktet

1. RFA përfshin të gjitha informatat e nevojshme për të aplikuar për një grant, megjithatë, pyetjet në këtë RFA duhet të dorëzohen tek:

Agron Selmani, Menaxher për grante
Zyra e projektit Avancojmë Kosovën së Bashku- Alternativa lokale
Sejdi Kryeziu, nr.16, Pejton, Prishtinë, 10000, Kosovë

Telefoni i zyres: 038 249 677/678
E-mail: grants@kcdf.org

Afati i fundit për pyetje është 20 mars 2015 në ora 3:30 pm. Si pyetjet ashtu edhe përgjigjet do të ofrohen për të gjithë aplikuesit deri më 23 mars 2015 ora 3:30 pm.

Organizatrat duhet të tregojnë GRUPIN specifik për të cilin ata janë duke aplikuar në kopertinën e Aplikacionit dhe në pjesën e jashtme të zarfit.

Ditët informuese me aplikuesit potencial do të organizohen si në vijim:

1. Asambleja Komunale në Pejë, adresa: 'Aleksandër Moisiu' p.n. Pejë më 16 mars, 2015 në ora 10:00
2. Zyra e AKTIV, adresa: Cika Jovina 3, Mitrovica veriore II/6, më 17 mars 2015 në ora 10:00
3. Asambleja Komunale Vushtrri më 17 mars 2015 në ora 14:00
4. Asambleja Komunale Graçanicë më 18 mars 2015 në ora 10:00
5. Shtëpia e Kulturës Kllokot më 18 mars 2015 në ora 14:00
6. Asambleja Komunale Shtërpçë më 19 mars 2015 në ora 10:00

Programi USAID/AKT-LS nuk do të mbulojë shpenzimet e pjesëmarrjes në seancat informuese.

Aplikuesit duhet të dorëzojnë aplikacionet në formatin/shabllonet si në vijim:

Shtojca 1: Aplikacioni për OJQ

2. Aplikantët e suksesshëm duhet të nënshkruajë të gjitha certifikatat në fuqi nga ADS 303.3.8: <http://www.usaid.gov/policy/ads/300/303.pdf>. Për këtë RFA, aplikuesit do të nënshkruajë vërtetimet e para nënshkrimit të marrëveshjes për grant, këto vërtetime janë etiketuar si në vijim:

- Një kopje e nënshkruar e vërtetimit lidhur me mos-financimin e terrorizmit që kërkohet nga InternalMandatory Reference AAPD 1/44;
- Vet-vërtetimi; dhe
- Vërtetimi i pranuesit

3. Aplikacionet mund të dorëzohen në anglisht, shqip dhe serbisht. Aplikantët duhet të dorëzojnë një kopje origjinale dhe një kopje në zarf të mbyllur në adresën e mësipërme. Nëse aplikacioni dërgohet me e-mail, ju lutemi në titull (subjectline) e shënoni "Avancojmë Kosovën së Bashku - Alternativa Lokale RFA-03-AKT-LS".

4. Avancojmë Kosovën së Bashku - Alternativa Lokale do të inkorporojë planin e aprovuar të etiketimit dhe shënimit (Approved Branding and Marking Plan) të USAID-i për të gjitha grantet nën këtë RFA.

5. Kufizimet e financimit:

- Aplikuesit inkurajohen që të dorëzojnë listën e tyre të mallrave të propozuara për t'u shqyrtuar nga AKT - LS gjatë procesit të vlerësimit. Megjithatë, ju lutemi vini re se çdo mall nga lista e mallrave të propozuara nga aplikuesi që nuk i plotëson kushtet i nënshtrohen miratimit nga AKT - LS. Një listë e plotë e mallrave të lejueshme dhe të kualifikuara mund të gjendet në ADS 312:<http://www.usaid.gov/policy/ads/300/312.pdf>
- Dhënia e grantit nuk mundëson rimbursimin e kostove të para-dhënies së grantit. Vetëm detyrimet e lejueshme të shkaktuara gjatë periudhës së përcaktuar në kuadër të marrëveshjes së grantit do të rimbursohen.

Aplikuesit duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim tek Avancojmë Kosovën së Bashku - Alternativa Lokale:

- Aplikacioni për OJQ;
- Një kopje e vlefshme e regjistrimit të ligjshëm të biznesit të aplikuesit;
- Kopjen e letërnjoftimit të Kosovës;

Kopjet fizike të aplikacionit mund të dorëzohen në një nga adresat e mëposhtme:

Zyra e CDF, Agron Selmani
Adresa: 'Sejdi Kryeziu', nr.16, Pejton, 10000, Prishtinë, Kosovë
Tel: 038 249 677
038 249 678

Zyra e AKTIV, Branislav Nesovic
Adresa: Cika Jovina 3, II/6, Mitrovica e veriut

Seksioni V: Informata mbi shqyrtimin e aplikacionit

1. AKT LS do të vlerësojë aplikacionet bazuar në arsyetimin për strategjinë e propozuar, arsyetimin për përfshirjen e zgjedhësve të caktuar dhe gjasat që strategjia të kontribuojë në objektivat e projektit AKT LS, si dhe të kriterëve të mëposhtme:

- Aftësia/angazhimi i demonstruar e aplikuesit për t'iu qasur dhe për të punuar me sukses me grupet e interesit siç janë zgjedhësit, organizatat e komunitet, shoqëritë kulturore dhe/apo grupe të tjera të shoqërisë civile;
- Përvoja paraprake në organizimin e aktiviteteve kulturore;
- Performanca paraprake dhe efektiviteti i aplikantit në arritjen e rezultateve;
- Interesimi aplikantit për të marrë pjesë në programin për ngritjen e kapaciteteve të AKT LS;
- Të përfshijë një numër të madh anëtarësisë në aktivitete;
- Të komunikojë rezultatet e veprimtarisë dhe rëndësinë e saj tek audiencia e gjerë.

Të gjitha aplikacionet do të vlerësohen në baza konkurruese në përputhje me kriteret e paraqitura më poshtë. Numri i pikëve të dhëna tregon rëndësinë relative të çdo faktori. Për ta bërë procesin e vlerësimit sa më objektiv të jetë e mundur, çdo aplikant duhet qartë të tregojë se si propozimi i tij plotëson kriteret e mëposhtme.

Kriteri	Maksimumi i pikëve
1. Projekt propozimi	50
2. Kostoja e propozuar	20
3. Kapaciteti organizativ dhe/apo potenciali dhe motivimi për të zhvilluar dhe për të menaxhuar projekte kulturore dhe performanca e mëhershme	30
Totali	100

1. Projekt Propozimi (50 pikë)

- Shkalla në të cilën projekti i propozuar është logjik, i mirë-konceptuar, teknikisht të shëndoshë, reflekton një vlerësim për problemet që mund të hasen dhe drejtpërdrejt trajton objektivat e identifikuara në këtë Ftesë për Aplikacione; (10 pikë)
- Shkalla në të cilën projekti i propozuar tregon: i) kuptim të qartë të çështjeve që do të trajtohen, ii) qasje origjinale ose të reja për çështjet në Kosovë, iii) një set konkret i rezultateve kuptimplotë dhe realiste për t'u arritur, dhe iv) një shpjegim logjik të asaj se si do të maten rezultatet; (10 pikë)
- Shkalla në të cilën aktivitetet e projektit të propozuar demonstrojnë ndikim afatgjatë dhe qëndrueshmëri; (10 pikë)
- Pajtueshmëria me synimet dhe objektivat e AKT LS. (20 pikë)

2. Kostoja e propozuar (20 pikë)

- Shkalla në të cilën kostot e propozuara janë reale dhe në përputhje me aktivitetet e projektit; (10 pikë)
- Niveli i angazhimit i demonstruar për të siguruar fonde për kontribut për bashkëfinancim. Pjesa e propozuar për bashkëfinancim do të vlerësohet duke u bazuar në nivelin e identifikuar të pjesëmarrjes financiare të aplikantit dhe vlerën e shtuar që ajo përfaqëson në program. (10 pikë)

3. Kapaciteti organizativ dhe/apo potenciali dhe motivimi për të zhvilluar dhe për të menaxhuar projekte kulturore dhe performanca e mëhershme (30 pikë)

- Shkalla në të cilën organizata aplikuese ka demonstruar përkushtim ndaj misionit të saj dhe aftësia për të kryer projektin e propozuar sipas planit, duke përfshirë

sistemet e përshtatshme menaxheriale dhe financiare, si dhe masa e diversitetit në udhëheqje dhe personel; (10 pikë)

- Shkalla në të cilën organizata aplikuese ka demonstruar aftësinë e udhëheqjes brenda sektorit të tyre të ekspertizës si dhe kapacitetin për të ofruar mbështetje dhe shërbime për zgjedhësit; (10 pikë)
- Shkalla në të cilën organizata aplikuese ka dëshmi të menaxhimit të projekteve të ngjashme në madhësi. (10 pikë)

Gjatë rrjedhës së shqyrtimit AKT LS mund të kërkojë informata shtesë nga aplikuesi lidhur me propozimin për grant apo për organizatën në përgjithësi. Kërkesa për informata shtesë nuk nënkupton që AKT LS do të mbështesë apo nuk do të mbështesë projektin; ajo thjesht tregon se informatat janë të nevojshme në mënyrë që të përfundojë procesi i vlerësimit.

2. Komisioni për shqyrtim dhe vlerësim(REC) i përbërë së paku nga tre persona do të shqyrtoj dhe vlerësoj të gjitha aplikacionet.

Seksioni VI: Informata për administrimin dhe dhënien e grantit

Pasi të lëshohet kjo RFA, çdo pyetje në lidhje me këtë RFA duhet t'i adresohet vetëm Menaxherit të granteve.

Pasi që REC të mbledh dhe vlerësoj aplikacionet, pranuesit e suksesshëm do të pranojnë një e-mail nga Menaxheri i Granteve për të caktuar detyrat e negociatave si në vijim:

- (1) Anketa e thjeshtuar e para-grantit (Simplified Pre-Award Survey)³ (për grantet në-mallra AKT - LS do të kryej vizita në terren para anketës për miratim);
- (2) Negociatat teknike/aktivitetit, duke përfshirë kosto-analizën e buxhetit;
- (3) Vlerësimet mjedisore, nëse konsiderohet e nevojshme.

Aplikuesit e pasuksesshëm do të njoftohen me shkrim brenda një jave pas takimit të REC.

Kërkesat e raportimit: kërkesat e progresit të programit dhe raportimit financiar do të vendosen gjatë negociatave.

Seksioni VII: Informata të tjera

1. USAID dhe/ose Avancojmë Kosovën së Bashku - Alternativa Lokale rezervon të drejtën për të financuar ndonjë ose asnjë prej aplikacioneve të dorëzuara. Përveç kësaj, të gjitha grantet në bazë të kësaj mundësie për financim varen nga disponueshmëria e fondeve dhe të marrjes së numrit të mjaftueshëm të aplikacioneve të merituar.

2. Aplikuesit këshillohen për:

NDALIMI I MBËSHTETJES SË TERRORIZMIT

- (a) Kontraktorit /Pranuesit këshillohet se U.S. Executive Orders dhe ligji amerikan ndalon transaksionet me, dhe sigurimin e burimeve dhe mbështetjes së, individëve dhe organizatave të lidhura me terrorizmin. Është përgjegjësi ligjore e Kontraktuesit/Pranuesit që të siguroj pajtueshmërinë me këto urdhëresa ekzekutive dhe ligje.

³Anketa e thjeshtuar e para-grantit (SPAS) përdoret për të përcaktuar se nëse aplikuesi ka kapacitet për të performuar në mënyrë të përshtatshme në përputhje me parimet e përcaktuara nga USAID dhe OMB në administrimin e një granti të financuar nga USAID. Të gjithë aplikuesit që kalojnë REC do t'i nënshtrohen SPAS-it (në përputhje me ADS 303.3.9). SPAS është një proces i bazuar në pyetje dhe përgjigje që zakonisht zhvillohet në zyrën e aplikuesit. Shqyrtohen të gjitha fushat e operimit, duke përfshirë por jo kufizuar në: buxhetimi, parat e gatshme, prokurimi, sistemi i kontabilitetit, inventari, etj. Nëse organizata tash së fundi ka pasur një anketë para grantit me AKT - LS, 12 muajt e fundit, organizata juaj me shumë gjasa nuk do të jetë subjekt i një tjetër SPAS-i.

- (b) Një nga urdhrat e aplikueshme është Executive Order 13224, e datës 24 shtator 2001. Uebfaqja e Zyrës për kontrollin e punëve të jashtme (OFAC) e Departamentit të Thesarit përmban tekstin e këtij Urdhri dhe një listë të individëve dhe subjekteve të caktuara në përputhje me to. Gjithashtu përmban listën e individëve dhe subjekteve të caktuara që janë subjekt i statuseve, rregulloreve dhe urdhëresave ekzekutive kundër terrorizmit. Shih <http://www.treasury.gov/offices/enforcement/ofac/sdn/>.
- (c) USAID-i rezervon të drejtën për të shqyrtuar dhe miratuar apo refuzuar këtë nën-grant të mëposhtëm nëse është propozuar sipas kësaj kontrate/marrëveshje: (i) çfarëdo kontrate ose nënkontrate që tejkalon \$25,000 me një organizatë jo-amerikane apo individ; dhe (ii) çdo grant apo nën-grant për një organizatë jo-amerikane apo individ, pavarësisht vlerës së dollarit. Për më tepër, kërkohet pëlqimi me shkrim i USAID-it para se disa forma të tjera të ndihmës mund të jepen për një organizatë apo individ jo amerikan. Këto përfshijnë asistencë në-mallra të tilla si: renovimin e objekteve të ndonjë OJQ-je, riparimin ose zëvendësimin e pajisjeve të kompanisë, si dhe aktivitete të caktuara të trajnimit. Asnjë miratim (ose dështimi për mos-aprovim) nga USAID-i nuk e liron Kontraktuesin/Pranuesin nga detyrimet e tij/saj ligjore në përputhje me Urdhëresat Ekzekutive (Executive Orders) dhe ligjet në fuqi.
- (d) USAID-i rezervon të drejtën të anulojë aprovimin e një nën-granti në rast se USAID më pas vihet në dijeni të informacionit që tregon se nën-granti është në kundërshtim me ligjin apo politikat amerikane kundër mbështetjes së terrorizmit. Në raste të tilla, zyrtari Kontraktues i USAID-it do të ofroj udhëzime me shkrim për Kontraktuesin/Pranuesin për anulimin e nën-grantit.
- (e) USAID-i rezervon të drejtën që të ndërpresë këtë kontratë/marrëveshje nëse përcakton se Kontraktori/Pranuesi është i përfshirë në ose përkrah veprimtarinë terroriste ose ka dështuar të pajtohet me ndonjë nga kërkesat e kësaj dispozite.
- (f) Kjo dispozitë, përfshirë edhe paragrafin (f), do të përfshihet në të gjitha kontratat, nënkontratat, grantet dhe nën-grantet e lëshuara sipas kësaj kontrate/marrëveshje. Kontraktuesi/Pranuesi duhet t'i ofroj Zyrtarit kontraktues/të marrëveshjes të USAID-it një kopje të faqeve nga çdo nën-grant që përmban këtë dispozitë.

POLITIKA –ASISTENCA E USAID PËR AFTËSINË E KUFIZUAR - (DHJETOR 2004)

- (a) Objektivat e Politikës së USAID-it për Aftësinë e Kufizuar janë (1) për të rritur arritjen e qëllimeve të programit të asistencës së jashtme të Shteteve të Bashkuara duke promovuar pjesëmarrjen dhe barazimin e mundësive të individëve me aftësi të kufizuara në politikën e USAID-it, strategjitë e vendit dhe të sektorit, aktivitetet e projektimit dhe zbatimit; (2) për të rritur ndërgjegjësimin për çështjet e personave me aftësi të kufizuara si brenda programeve të USAID-it ashtu edhe në vendet pritëse; (3) për të angazhuar agjencitë e tjera qeveritare të SHBA, homologët e vendit mikpritës, qeveritë, organizatat zbatuese dhe donatorët e tjerë në nxitjen e një klime të mos-diskriminimit ndaj personave me aftësi të kufizuara; dhe (4) për të mbështetur avokimin ndërkombëtar për personat me aftësi të kufizuara. Teksti i plotë i dokumentit të politikave mund të gjendet në faqen e internetit në vijim: http://pdf.dec.org/pdf_docs/PDABQ631.pdf.
- (b) Prandaj USAID kërkon që pranuesi të mos diskriminojë personat me aftësi të kufizuar në zbatimin e programeve të financuara nga USAID-i dhe që ai/ajo të bëjë çdo përpjekje për të përmbushur objektivat e Politikës së USAID-it për Aftësinë e Kufizuar në kryerjen e programit sipas këtij granti ose marrëveshje bashkëpunuese. Për këtë qëllim dhe për aq sa ajo mund të përmbushë këtë qëllim në kuadër të objektivave të programit, pranuesi duhet të demonstrojë një qasje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme që të përfshijë burra, gra dhe fëmijë me aftësi të kufizuara.

Kufizimi në Origjinën e Burimit - përfituesi nuk duhet të blejë ndonjë nga mallrat e prodhuara në vendet që janë në listën e vendeve të ndaluara (referencë ADS310, Origjina e burimit, kombësia: <http://www.usaid.gov/policy/ads/300/310.pdf>)

TRAFIKIMI ME PERSONA (QERSHOR 2012)

a. USAID-i është i autorizuar të ndërpresë këtë grant, pa asnjë penalizim, nëse pranuesi ose punonjësit e tij/saj, ose ndonjë nën-pranues ose punonjësit e tij/saj, angazhohen në ndonjë nga sjelljet e mëposhtme:

(1) Trafikimi me persona (i përcaktuara në Protokollin për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit me persona, veçanërisht me gra dhe fëmijë, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar) gjatë periudhës së këtij granti;

(2) Prokurimi në një akti të seksit komercial gjatë periudhës së këtij granti; ose

(3) Përdorimi i punës së detyruar në kryerjen e këtij granti.

b. Për qëllime të kësaj dispozite, "punonjës" nënkupton një individ i cili është i angazhuar gjatë kryerjes së këtij grant si punonjës i drejtpërdrejtë, konsulent, apo vullnetar i pranuesit ose ndonjë nën-pranuesi.

c. Pranuesi duhet të përfshijë në të gjitha nën-marrëveshjet, duke përfshirë edhe nën-grantet dhe kontratat, një dispozitë që ndalon sjelljet e përshkruara nën (1) - (3) nga nën-pranuesi, kontraktuesi ose ndonjë prej punonjësve të tyre.

Seksioni VIII: Shtojcat

Shtojca 1: Aplikacioni për OJQ